

S2 Albania Sh.p.k

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

mazars

PËRMBAJTJA

RAPORTI AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	5
PASQYRA E NDRYSHIMIT NË KAPITAL	6
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	7
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE	8- 35

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakët e Shoqërisë S2 Albania Sh.p.k

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë S2 Albania Sh.p.k (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me perjashtim të efekteve të çështjes së përshkruar në bazat për opinion të kualifikuar, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin e kualifikuar

Siç përshkruhet në shënimin 1.1 të pasqyrave financiare, Shoqëria operon në bazë të marrëveshjes së konçesionit me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Të gjithë investimet e kryera nga shoqëria janë njohur dhe paraqitur në zërin e Aktiveve Afatgjata Materiale në përputhje me SNK 16 "Aktivet Afatgjata Materiale" dhe të amortizuara në përputhje me vlerësimet e përshkruara në shënimin 4.4 të këtyre pasqyrave financiare. Ndërkohë, kushtet e kësaj marrëveshjeje janë në përputhje dhe duhet të trajtohen sipas modelit financiar në kuadër të KIRFN 12 "Marrëveshjet konçesionare të shërbimit". Bazuar në informacionin që kemi, ne nuk mund të vlerësojmë efektin që trajtimi i marrëveshjes së konçesionit sipas kërkesave të KIRFN 12 në vend të SNK 16 do të kishte në aktivet afatgjata materiale, aktivet financiare, fitimet e pashpërndara dhe fitimin e vitit aktual.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

mazars

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

27 qershor 2022


mazars
Irena Hoxha
Auditues Ligjor
Bin Durraku Str., Binjaket Build.,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUI: K32123006W

S2 Albania Sh.p.k**Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021***(vlerat në LEK)*

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
AKTIVE			
Aktivët afatgjatë			
Aktivët afatgjatë materiale	6	392,641,870	486,877,692
Aktivët me të drejtë përdorimi	6	108,596,732	85,863,755
Llogari të tjera të arkëtueshme	7	6,465,994	6,465,994
Llogari të arkëtueshme tregtare	9	-	414,996,393
Total aktiveve afatgjatë		507,704,596	994,203,834
Aktivët afatshkurtra			
Llogari të arkëtueshme tregtare	9	536,650,241	127,640,174
Llogari të arkëtueshme të tjera	10	594,639,986	163,416,213
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	8	4,218,025	137,833,309
Aktive tatimore të shtyra	11	9,272,770	40,143,088
Mjetet monetare në arkë e në bankë	12	111,402,622	86,231,211
Total aktive afatshkurtra		1,256,183,644	555,263,995
Total aktive		1,763,888,240	1,549,467,829
KAPITALI			
Kapitali		1,000	1,000
Rezerva të tjera		546,321,678	294,662,600
Rezerva ligjore		100	100
Fitim / (humbja) ushtrimit		140,915,296	251,659,078
Total kapitali	13	687,238,074	546,322,778
DETYRIME			
Detyrime afatgjatë			
Detyrim për qira	14	90,760,501	74,068,207
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	15	40,020,254	40,020,254
Llogari të pagueshme tregtare	16	-	110,894,910
Total detyrime afatgjatë		130,780,755	224,983,371
Detyrime afatshkurtra			
Detyrim për qira	14	22,114,094	15,567,860
Llogari të pagueshme tregtare	16	546,751,702	199,293,093
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	15	4,697,075	210,799,376
Detyrime tatimore	17	47,681,182	15,885,225
Llogari të pagueshme të tjera	18	324,625,358	336,616,126
Total detyrime afatshkurtra		945,869,411	778,161,680
Totali i detyrimeve		1,076,650,166	1,003,145,051
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,763,888,240	1,549,467,829

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 35, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

S2 Albania Sh.p.k**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021***(vlerat në LEK)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	19	1,613,921,599	1,578,319,002
Të ardhura të tjera		-	-
Total të ardhura		1,613,921,599	1,578,319,002
Furnitura, shërbime direkte dhe të konsumueshme	20	(870,561,894)	(838,771,379)
Shpenzime personeli	21	(274,742,204)	(271,168,913)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	6	(115,670,374)	(138,523,348)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	22	(87,238,281)	(82,790,958)
Fitimi operativ		265,708,846	247,064,404
Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra	23	(78,109,886)	53,634,389
Të ardhura / (shpenzime) interesi dhe të ngjashme (neto)		1,868,543	(4,785,010)
Të ardhura / (shpenzime) të tjera financiare (neto)		(15,814,094)	5,705,528
Total shpenzime financiare	24	(13,945,551)	920,518
Fitimi/humbja para tatimit		173,653,409	301,619,311
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	25	(32,738,113)	(49,960,233)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(1,867,795)	-
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		(30,870,318)	(49,960,233)
Fitimi/humbja e vitit		140,915,296	251,659,078
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		140,915,296	251,659,078

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 35, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

S2 Albania Sh.p.k


Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat në LEK)

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2020	1,000	100	-	294,662,600	294,662,600
Fitimi / Humbja e vitit	-	-	-	251,659,078	251,659,078
Levizje permes kapitalit	-	-	294,662,600	(294,662,600)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	1,000	100	294,662,600	251,659,078	546,322,778
Fitimi / Humbja e vitit	-	-	-	140,915,296	140,915,296
Levizje permes kapitalit	-	-	251,659,078	(251,659,078)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021	1,000	100	546,321,678	140,915,296	687,238,074

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 35, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 janë aprovuar nga administratori i S2 Albania Sh.p.k. më ___/03/2022 dhe janë firmosur si më poshtë:


Jonathan Fleming
 Administrator



I.L.D.-99 Audit shpk

I.L.D.-99 Audit shpk
 Hartues i Pasqyrave Financiare

S2 Albania Sh.p.k**Pasqyra e fluksit të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021***(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)*

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	173,653,409	301,619,311
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	115,670,374	138,523,348
Shpenzimet financiare jomonetare	4,192,559	4,895,965
Fitimi operativ përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues	293,516,342	445,038,624
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues:</i>		
Ndryshimi në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(415,203,674)	(338,253,545)
Ndryshimi në llogari të pagueshme dhe të tjera	256,368,888	144,672,360
Ndryshimi në parapagime e shpenzime të shtyra	133,615,284	131,374,528
Ndryshimi në të pagueshme për shpenzime të konstatuara	(206,102,301)	(326,645,717)
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	62,194,539	56,186,250
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(11,901,568)	(28,806,878)
Total tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(11,901,568)	(28,806,878)
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata material	(3,626,141)	(2,710,904)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(3,626,141)	(2,710,904)
Aktivitetet financuese		
Shtesa/pakesime në qera financiare	(21,495,419)	(19,035,648)
Dividendë të paguar	-	-
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	(21,495,419)	(19,035,648)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	25,171,411	5,632,820
Mjetet monetare në fillim të periudhës	86,231,211	80,598,391
Mjetet monetare në fund të periudhës	111,402,622	86,231,211

12

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 35, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. NFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqëria "S2 Albania" është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 22.05.2013.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është zbatimi i marrëveshjes së koncesionit në lidhje me skanimet e mallrave të importuara, automjeteve, kontenjerëve etj në pikat doganore Shqiptare si dhe cdo aktivitet tjetër lidhur me këtë ose i kërkuar për të realizuar zbatimin e marrëveshjes. Shoqëria ka të drejtën të kryejë cdo transaksion si veprimtari tregtare, financiare, qiradhënie, qiramarrje etj që mund të konsiderohet i dobishëm ose i nevojshëm për arritjen e objektivit të lartpërmendur të shoqërisë.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga dytesore Tirane-Durres, km 9, godina nr pasurie 83/7/3 zona kadastrale 2105.

Administrator i shoqërisë "S2 Albania" është Z.Jonathan Fleming.

Ajo është regjistruar në Drejtorinë e Tatimpaguesëve të Mëdhenj me NIPT L31722010Q.

Më 31 dhjetor 2021 Shoqëria kishte 131 punonjës (2020: 131 punonjës).

1.1. Marrëveshja e Koncesionit

Përshkrimi i marrëveshjes

Marrëveshja Koncesioni është lidhur midis Ministrisë së Financave, (sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë) duke vepruar për llogari të Republikës së Shqipërisë sipas autorizimit dhënë nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 755, datë 2.11.2011, dhe Rapiscan Systems, INC. me numër 954-41- 3488, shoqëri e organizuar sipas ligjeve të Kalifornisë, USA, për "Financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të konteinerëve e automjeteve të tjera në republikën e shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit" Shoqëria Rapiscan Systems, INC themeloi shoqërinë S2 Albania shpk për qëllime të Marrëveshjes së Koncesionit.

Periodha e marrëveshjes

Marrëveshja e Koncesionit është lidhur për një periudhe prej 15 vjet dhe fillon nga data efektive e operimit për cdo pikë doganore operimi. Data efektive e operimit në pikën e parë doganore është 07 Shtator 2015.

Objekti i marrëveshjes

Autoriteti me anë të kësaj kontrate angazhon operatorin për kohëzgjatjen e kësaj marrëveshjeje për të siguruar zbatimin e projektit, dizenjimin, testimin dhe operimin e sistemit, duke ofruar shërbimet e përcaktuara dhe transferimin e vendeve dhe pajisjeve tek Autoriteti mbas mbarimit të kohëzgjatjes në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Kontrate. Detyrimet e operatorit për të siguruar skanimin e kontejnerëve do të limitohet vetëm brenda vendeve dhe shërbimeve të përcaktuara. Sipas marrëveshjes shoqëria ushtron operimin e shërbimit të skanimit të konteinerëve e automjeteve të tjera në pesë pika doganore; i) Durrës, ii) Kapshticë, iii) Kakavijë, iv) Qafë Thanë, v) Morinë

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM (vazhdim)

1.1. Marrëveshja e Konkensionit (vazhdim)

Pagesa

Autoriteti do t'i paguajë operatorit një tarifë për shërbimet e caktuara për çdo vend (Tarifa e Shërbimit të Vendit). Tarifa e Shërbimit të Vendit do të llogaritet dhe do të paguhet në këste mujore të njëjta, secila në vlerën e 1/12 të Tarifës Vjetore të Vendit. Tarifa e Shërbimit të Vendit do të jetë pa TVSH.

Tarifa e konkensionit

Operatori detyrohet t'i paguajë Autoritetit një tarifë mujore konkensionit të llogaritur në 2% të Tarifës së Shërbimit të Vendit. Kjo tarifë konkensionare mbahet nga Tarifa e Shërbimit të Vendit që i paguhet operatorit nga Autoriteti.

2. Bazat e përgatitjes

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Informacionet në lidhje me zonat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabël të cilat më së shumti ndikojnë në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare, janë paraqitur në shënimin nr. 5.

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri.

Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatit e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3. Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme.

Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)

3. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

3.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 janar 2021, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani:

- Konçensione të lidhura me qiratë në kushtet e COVID-19 përtej 30 qershor 2021 (Ndryshime në SNRF 16)
- Reforma e Referencës së Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7) Faza 2

3.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standarde dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon ti aplikojë këto standarde dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbyllur më 31 dhjetor 2021:

- Kontratat me kushte – Kostoja e përbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37) – Në fuqi nga 1 janari 2022
- Aktive afatgjatë materiale: Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16) - Në fuqi nga 1 janari 2022
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve SNRF 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41) - Në fuqi nga 1 janari 2022
- Referencat në Kuadrin Konceptual (Ndryshimet në SNRF 3). Në fuqi nga 1 janari 2022
- Dhënia e shënimeve shpjeguese të politikave kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës IFRS 2) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshimet në SNK 8) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet në SNK 12) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- SNRF 17 – Kontratat e Sigurimeve – Në fuqi më 1 janar 2023

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit.

(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
EUR/Lek	120.76	123.70
USD/ Lek	106.54	100.84

4.2. Instrumenta financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiarë – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes. Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivitetit.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrë se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumenta financiarë (vazhdim)

Aktivitet financiarë – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e flukseve monetare. Kur modeli i biznesit është mbajtura e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për ti shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në

VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 5 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

Aktivitet financiarë – pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësisë ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivitet financiarë që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

Aktivitet financiarë - çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivitet financiarë kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivitet financiarë ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësisive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivitet financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitet financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Detyrimet financiarë – kategoritë e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumenta financiarë (vazhdim)

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhen (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

Kompensimi i instrumenteve financiare. Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shumata neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërish e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë është shumata në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shumata në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përlllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

4.3. Inventari

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën FIFO (dalja e parë hyrja e parë). Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

*(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)***4. Politikat Kontabël (vazhdim)****4.4. Aktive afatgjata materiale***i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proçes" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivitetit duke zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në bazë të vlerës së mbetur, duke përdorur normat e përcaktuara nga menaxhimi.

Vlera e mbartur e aktiveve afatgjata materiale rishikohen për zhvlerësim kur ngjarje apo ndryshime në rrethanat tregojnë se vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, kur vlera kontabël tejkalon vlerën e rikuperueshme të vlerësuar aktivitetit paraqiten me vlerën e tyre të rikuperueshme, e cila është më e larta mes vlerës së tyre të drejtë minus kostot për shitje dhe vlerës së tyre në përdorim.

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Instrumenta dhe vegla pune	Vlera e mbetur	20 %
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje kompjuterike	Vlera e mbetur	25 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20 %

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5. Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16)

Njësia ekonomike vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira në fillim të kontratës. Një qira përmban të drejtën për të përfutur përdorimin dhe për të marrë në thelb të gjitha përfitimet ekonomike të një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të flukseve dalese.

Në datën e fillimit të qirasë, njësia ekonomike njih një aktiv me të drejtë përdorimit dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike. Aktivi i së drejtës së përdorimit matet me kosto, i cili përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga njësia ekonomike, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të qirasë, dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo zbritje e marrë). Njësia ekonomike zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në më të hershmen midis fundit të jetës së dobishme të aktivit me të drejtë përdorimi dhe afatit të qirasë. Njësia ekonomike gjithashtu zhvlerëson aktivin me të drejtë përdorimi kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, njësia ekonomike mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, e skontuar me normën shtesë të huamarrjes së njësisë ekonomike, pasi që kontratat e qirasë negocohen me palët e treta nuk është e mundur të përcaktohet norma e interesit që nënkuptohet në qira.

Norma rritëse e huamarrjes është norma e vlerësuar që njësia ekonomike duhet të paguajë për të marrë hua të njëjtën shumë gjatë një afati të ngjashëm, dhe me siguri të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë në substancë fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet te cilat kanë një bazë të arsyeshme që do të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, pasivi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që shpërndahen midis ripagimeve të principalit dhe kostove financiare. Kostoja financiare është shuma që prodhon një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. Aktivi i së drejtës së përdorimit rregullohet për të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.5. Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16)

Njësia ekonomike ka zgjedhur të regjistrojë qira afatshkurtra dhe qira të aktiveve me vlerë të ulët duke përdorur përshtatjet praktike. Në vend që të njohim një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe detyrimin e qirasë, pagesat në lidhje me to njihen si një shpenzim në fitim ose humbje mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

4.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysht shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

4.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.11. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.10. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15% (2020: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

4.12. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.13. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.14. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

(vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

Jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale

Siç është përshkruar në shënimin 4.4 Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale nuk ka ndryshuar.

Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPI")

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa principali dhe interesi kërkon gjykim.

Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

Matjet humbjeve të parashikuara të kredive

Niveli i humbjeve nga zhvlerësimi llogaritet për llogaritë e arkëtueshme të matura me koston e amortizuar. Meqenëse të arkëtueshmet tregtare nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, niveli i humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kreditit. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provizionesh në të cilën llogariten kostot e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme të vjetra ose të vonuara.

Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në Shoqëri. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, të ardhurat, fluksi i parasë, zhvlerësimi i aktiveve, vlera e drejtë dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, Shoqëria po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

S2 Albania Sh.p.k

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2021

(Vlerat në LEK përveçse kur është shprehur ndryshe)

6. Aktive afatgjata materiale

<i>Kosto</i>	Makinieri				Mobilje		Pajisje		Instrumenta		Aktivet me të drejtë përdorimi		Totali
	Pajisje	Automjetet	orendi	kompjuterike	Pajisje	kompjuterike	Pajisje	Pune	Pajisje	Pune	Pajisje	Pune	
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	1,344,204,574	17,328,551	7,629,796	11,286,247	3,873,232	118,272,770	1,502,595,170						
Shtesa	-	-	218,344	912,250	1,580,310	-	2,710,904						
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	1,344,204,574	17,328,551	7,848,140	12,198,497	5,453,542	118,272,770	1,505,306,074						
Shtesa			1,084,698	2,461,443	80,000	40,541,388	44,167,529						
Gjendja më 31 Dhjetor 2021	1,344,204,574	17,328,551	8,932,838	14,659,940	5,533,542	158,814,158	1,549,473,603						
<i>Amortizimi i akumuluar</i>													
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	756,451,412	11,475,325	3,678,627	4,631,327	2,077,834	15,726,754	794,041,279						
Amortizimi i vitit	117,550,632	1,170,645	290,273	1,822,148	1,007,389	16,682,261	138,523,348						
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	874,002,044	12,645,970	3,968,900	6,453,475	3,085,223	32,409,015	932,564,627						
Amortizimi i vitit	94,040,506	936,516	310,996	1,565,711	1,008,234	17,808,411	115,670,374						
Gjendja më 31 Dhjetor 2021	968,042,550	13,582,486	4,279,896	8,019,186	4,093,457	50,217,426	1,048,235,001						
<i>Vlera neto kontabël</i>													
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	587,753,162	5,853,226	3,951,169	6,654,920	1,795,398	102,546,016	708,553,891						
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	470,202,530	4,682,581	3,879,240	5,745,022	2,368,319	85,863,755	572,741,447						
Gjendja më 31 Dhjetor 2021	376,162,024	3,746,065	4,652,942	6,640,754	1,440,085	108,596,732	501,238,602						

7. Llogari të tjera të arkëtueshme

Llogari të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Garanci bankare për kartën e kreditit	3,968,276	3,968,276
Granci për Qera	2,497,718	2,497,718
	<u>6,465,994</u>	<u>6,465,994</u>

8. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagime dhe shpenzime të shtyra më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
<i>Afatshkurta</i>		
Shpenzime për shërbime teknike	2,118,000	2,047,800
Shpenzime për siguracione	1,641,927	2,197,033
Parapagime ndaj furnitoreve	458,098	167,039
Shpenzime të shtyra për licence	-	133,421,437
	<u>4,218,025</u>	<u>137,833,309</u>

9. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Drejtoria e Pergjithshme e Doganave	<u>536,650,241</u>	<u>542,636,567</u>
<i>Afat shkurta</i>	536,650,241	127,640,174
<i>Afat gjata</i>	-	414,996,393
	<u>536,650,241</u>	<u>542,636,567</u>

10. Llogari të arkëtueshme të tjera

Llogari të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si në vijim:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Hua për RS UK	483,040,000	61,850,000
TVSH e zbritshme	129,034,891	50,925,005
Zhvlërsim i kërkesave të arkëtueshme për TVSH	(129,034,891)	(50,925,005)
Tatim Fitimi	111,599,986	101,566,213
	594,639,986	163,416,213

Lëvizja e zhvlërsimit gjatë periudhës:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Çelja më 1 Janar	50,925,005	104,559,394
Rrimarje gjate vitit	-	(104,559,394)
Zhvlërsimi gjatë vitit	78,109,886	50,925,005
Gjendja 31 dhjetor	129,034,891	50,925,005

Shoqëria ka zhvlërsuar kërkesat e arkëtueshme për TVSH-në sipas politikave të saj të zhvlërsimit të kërkesave të arkëtueshme.

11. Aktive tatimore të shtyra

Aktive tatimore të shtyra më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si në vijim:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Tatim fitimi i shtyrë për shpenzime të përlogaritura përkohësisht të pa njohura	6,003,038	37,159,763
Tatim fitimi i shtyrë për shpenzime të përlogaritura për punonjësit	2,439,902	2,354,898
Tatim fitimi i shtyrë për aplikimin e IFRS 16	829,830	628,427
	9,272,770	40,143,088

12. Mjete monetare në arkë dhe bankë

Mjete monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
<i>Mjete monetare në bankë</i>		
Banka në EUR	96,767,296	28,864,459
Banka në Lekë	7,553,017	56,836,698
Banka në USD	7,066,132	514,587
Arka	16,177	15,467
	<u>111,402,622</u>	<u>86,231,211</u>

13. Kapitali

Më 31 dhjetor 2021 kapitali i shoqërisë "S2 Albania" sh.p.k është 1,000 lekë, i ndarë në 1,000 kuota me vlerë nominale 1 lek.

14. Detyrime për qira

Detyrime për qirate më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
<i>Afatshkurta</i>		
Detyrime për qera financiare	22,114,094	15,567,860
<i>Afatgjata</i>		
Detyrime për qera financiare	90,760,501	74,068,207
	<u>112,874,595</u>	<u>89,636,067</u>

15. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Të pagueshme për shpenzime të konstatuara më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
<i>Afatshkurta</i>		
Shpenzime për fatura të pa mbëritura	4,697,075	3,087,875
Të tjera shpenzime të përlogaritura	-	207,711,501
<i>Afatgjata</i>		
Të tjera shpenzime të përlogaritura	40,020,254	40,020,254
	<u>44,717,329</u>	<u>250,819,630</u>

16. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si në vijim:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
<i>Të pagueshme tregtare ndaj paleve të lidhura</i>	512,102,883	279,741,472
Furnitorë të huaj	26,418,322	24,097,355
Furnitorë vendas	8,230,497	6,349,176
<i>Afatshkurta</i>	<i>546,751,702</i>	<i>199,293,093</i>
<i>Afatgjata</i>	-	110,894,910
	546,751,702	310,188,003

17. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2021 janë si në vijim:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Tatim në burim	40,494,395	9,748,267
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	4,320,117	3,714,838
Tatimi mbi të ardhurat personale	2,866,670	2,422,120
	47,681,182	15,885,225

18. Llogari të pagueshme të tjera

Llogari të pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si në vijim:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Dividentë për tu paguar	303,740,755	303,740,755
Pushime të përlogaritura	16,266,007	15,699,313
Provizione	2,463,758	2,463,758
Paga ndaj personelit	2,154,838	14,712,300
	324,625,358	336,616,126

Provizionet afatshkurtra dhe afatgjata për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten në tabelen e mëposhtme:

	31 dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Balanca në celje	2,463,758	2,463,758
Provizion periudhes	-	-
Balanca në fund	2,463,758	2,463,758

19. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë gjeneruar nga aktivitetet si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Të ardhura nga shërbimi i skanimit	1,608,646,465	1,578,085,600
Të ardhura nga shitja e mallrave	5,275,134	233,402
	1,613,921,599	1,578,319,002

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së dhe Tatim Fitimit.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Qarkullim i tatueshëm	1,613,921,599
Shuma e qarkullimit e korrektuar	1,613,921,599
Sipas Kontabilitetit	1,613,921,599
Diferenca	-
Fitim nga këmbimet valutore	41,374,403
Të ardhura nga interes	6,335,764
Total të ardhura deklaruar në deklaratën e Tatim Fitimit	1,661,631,766

20. Materiale të para dhe të konsumueshme

Materiale të para dhe të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Shërbime për kuotën pjesë të vlerës së investimeve ndërtimore të kryera dhe shërbimet, mirëmbajtjen operacionale të pikave	351,088,846	344,396,663
Shërbime manaxheriale	224,490,282	197,510,560
Shpenzime për shfrytëzim licence teknike software	133,421,436	133,421,437
Markë tregtare dhe honorare	74,638,065	73,466,514
Mirëmbajtje dhe riparime pajisjet	38,988,595	44,212,369
Tarifa e konçesionit	32,173,326	31,561,138
Shpenzime për karburant makinat	6,266,961	5,769,442
Uniforma për punonjësit	3,311,226	4,640,396
Kosto e mallrave të shitur	3,254,844	-
Qera makina	2,090,663	2,965,275
Shpenzime dosimetriimi dhe kalibrimi	601,000	354,000
Materiale të konsumueshme	212,893	162,838
Shpenzime transporti	23,757	31,547
Shpenzime trajnimi për punonjësit	-	279,200
	870,561,894	838,771,379

21. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Paga dhe shpërblime	245,063,172	240,549,219
Shpenzime të sigurimeve shoqërore e shëndetësore	29,112,334	27,595,757
Pushime të përlogaritura	566,698	2,403,937
Benefite të tjera për stafin	-	620,000
	274,742,204	271,168,913

21. Shpenzime personeli (vazhdim)

Numri mesatar i personelit sipas funksioneve është si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Punonjës të administratës	5
Operator	126
	131

22. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	27,029,205	22,768,751
Konsulenca ekonomike dhe juridike etj	18,095,731	23,141,500
Siguracione	13,640,266	9,657,909
Energji elektrike, uje	8,809,742	9,191,816
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	8,147,286	8,133,436
Materiale të konsumueshme	4,249,702	3,932,142
Mirëmbajtje dhe riparime	1,494,758	2,022,155
Shpenzime marketingu dhe publiciteti	1,444,056	272,860
Taksa dhe kotroll teknik makinat	1,401,804	1,446,572
Shpenzime për pritje	1,204,810	59,805
Taksa Lokale	848,779	831,413
Komisione bankare	366,317	293,305
Shpenzime qeraje	220,757	242,731
Kancelari	169,133	177,740
Gjoha dhe penalitete	60,538	24,890
Shpenzime të tjera	28,856	35,066
Shpenzime rekrutimi	26,541	-
Ndihmë për tërmetin	-	558,867
	87,238,281	82,790,958

23. Zhvlerësim i aktiveve financiare

Zhvlerësim i aktiveve financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
<i>Balanca në celje</i>	50,925,005	104,559,394
Zhvlerësime gjatë periudhës	78,109,886	50,925,005
Rimarrje gjatë periudhës	-	(104,559,394)
Efkti neto në rezultat	78,109,886	(53,634,389)
<i>Balanca në mbyllje</i>	129,034,891	50,925,005

24. Shpenzime financiare neto

Shpenzimet financiare neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>
Shpenzime për interesa qera financiare	4,467,221	4,895,965
Të ardhura nga interesat	(6,335,764)	(110,955)
Humbje nga këmbimet valutote	57,188,497	100,212,515
Të ardhura nga këmbimet valutore	(41,374,403)	(105,918,043)
	13,945,551	(920,518)

25. Tatim fitimi

Shpenzimi për tatim fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 është përlllogaritur si në vijim:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Fitimi para tatimit	173,653,409	301,619,311
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	(100,624,210)	(362,196,544)
Shpenzime pritje dhe përcjellje	730,450	39,873
Shpenzime udhëtimi	25,382,952	22,600,535
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	60,538	34,890
Shpenzime të përlllogaritura përkoheisht të panjohura	-	177,931,304
Rimarrje përlllogaritje shpenzimesh	(207,711,501)	(515,187,853)
Zhvlerësim i kërkesave për arkëtim (TVSH)	78,109,886	50,925,005
Rimarrje e zhvlerësimit të aseteve (TVSH)	-	(104,559,394)
Rimarrje e shpenzimev të përlllogaritura për punonjësit nga viti i kaluar	(7,854,174)	(7,275,137)
Shpenzime të përlllogaritura për punonjësit	8,420,872	9,679,075
Shpenzime të njohura për qera	(20,932,946)	(19,793,840)
Shpenzime të panjohura për qera sipas IFRS 16	22,275,632	21,578,226
Shpenzime të tjera	894,081	1,830,772
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	73,029,199	(60,577,233)
Humbje fiskale e mbartur nga vit 2020	(60,577,233)	
Rezultati Fiskal	12,451,967	(60,577,233)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	1,867,795	-
Shpenzimi i tatim fitimi i shtyrë	30,870,318	49,960,233
	140,915,296	251,659,078

25.1 Tatimi i shtyrë:**25.1.1 Paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Tatim fitimi i shtyrë për shpenzime të përlllogaritura përkoheisht të pa njohura	6,003,038	37,159,763
Tatim fitimi i shtyrë për shpenzime të përlllogaritura për punonjësit	2,439,902	2,354,898
Tatim fitimi i shtyrë për aplikimin e IFRS 16	829,830	628,427
	9,272,770	40,143,088

25. Tatim fitimi (vazhdim)**25.1 Tatimi i shtyrë: (vazhdim)****25.1.2 Paraqitur në Pasqyrën e Performances Financiare**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Tatim fitimi i shtyrë e ardhur (shpenzim) për shpenzime të perlllogaritura përkohësisht të pa njohura	(31,156,726)	(50,588,483)
Tatim fitimi i shtyrë e ardhur (shpenzim) për shpenzime të perlllogaritura për punonjësit	85,005	360,591
Tatim fitimi i shtyrë e ardhur (shpenzim) për aplikimin e IFRS 16	201,403	267,658
Tatim i shtyrë e ardhur (shpenzim)	(30,870,318)	(49,960,234)

25.1.3 Rakordimi

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Balanca me 01 janar	40,143,088
Tatimi i shtyrë e ardhur (shpenzim) gjatë vitit	(30,870,318)
Balanca më 31 dhjetor	9,272,770
Llogaritja e Tatim fitimit të shtyrë për periudhën	
Rimarrje përlllogaritje shpenzimesh nga vitet e kaluara	(207,711,501)
Shpenzime të perlllogaritura për punonjësit	8,420,872
Rimarrje e shpenzimeve të perlllogaritura për punonjësit nga viti i kaluar	(7,854,173)
Shpenzime të panjohura për qera sipas IFRS 16	22,275,625
Shtuar shpenzime të njohura për qera	(20,932,946)
Total	(205,802,123)
Tatim fitimi i shtyrë 15%	(30,870,318)

26. Transaksionet me palët e lidhura

Palë të lidhura me Shoqërinë konsiderohen:

(a) individë ose anëtarë të afërm të familjes së tyre të cilët: (i) zotërojnë kontroll mbi Shoqërinë individualisht ose bashkarisht; (ii) kanë influencë të konsiderueshme mbi veprimtarinë e Shoqërisë; ose (iii) janë anëtarë të manaxhimit kryesor të Shoqërisë.

26. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

(b) entitete për të cilët plotësohet një nga kushtet: (i) entiteti dhe Shoqëria janë anëtarë të të njëjtit grup; (ii) njëra nga entitetet është një filial ose investim i një pale të tretë; (iii) të dy entitetet janë investim nga e njëjta palë e tretë; (iv) një entitet është investim i një pale të trete dhe ky i fundit është filial i tij; (v) entiteti është një plan përfitim pas-punësimit për të mirën e të punësuarve e Shoqërisë ose një entiteti i lidhur me Shoqërinë; (vi) entiteti kontrollohet ose ka kontroll të përbashkët nga një individ që përmbush kriterin (a); dhe (vii) një individ sipas kriterit (a), (i) që ka influencë mbi entitetin ose është anëtar i manaxhimit kryesor të Shoqërisë.

26.1 Veprime në lidhje me aktivitetin

Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020, shoqëria ka pasur veprime me palë të lidhura për aktivitetin e saj si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Blerje		
Rapiscan UK	71,233,280	150,002,199
Rapiscan USA	7,859,317	22,464,531
OSI Corporate	6,578,560	3,121,909
ICMS	351,088,846	344,396,663
S2 Global	444,404,094	465,500,872
	881,164,097	985,486,174
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shitje		
Rapiscan UK	6,335,764	11,402,986
	6,335,764	11,402,986

Shitje mallrash dhe/ose shërbimesh ndaj palëve të lidhura janë bërë me çmimet që Shoqëria zbaton me palë të treta duke bërë zbritje në varësi të volumeve dhe produkteve.

Blerjet janë bërë me çmimet e tregut të zbritura këto për të reflektuar cilësinë e produkteve si dhe marrëdhënien e biznesit mes palëve.

26. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

26.1 Veprime në lidhje me aktivitetin (vazhdim)

Tepricat e mbetura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 me palët të lidhura të Shoqërisë janë detajuar si në vijim:

Balancat me palët e lidhura	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Të pagueshëm		
Rapiscan UK	106,642,283	78,679,471
Rapiscan USA	6,611,869	6,573,289
OSI Corporate	5,705,775	2,629,674
ICMS	178,339,745	145,845,801
S2 Global	214,803,211	46,013,237
Totali	512,102,883	279,741,472
Të arkëtueshme		
Rapiscan UK	483,040,000	61,850,000
	483,040,000	61,850,000

Vlerat e mbetura në fund të vitit, do të shlyen përkatësisht sipas natyrës. Në lidhje me këto vlera nuk ka garanci të marra ose të dhëna

27. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua dhe llogari të arkëtueshme, dhe mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit. Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

27. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)**Risku i normave te interesit**

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit. Aktivët dhe detyrimet e Shoqërisë nuk mbartin risk të normave të interesit.

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

Përshkrimi	31 dhjetor 2021				
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	1,131,290,227		6,465,994		1,137,756,221
Mjete monetare në arkë dhe bankë	111,402,622				111,402,622
Totali	1,242,692,849	-	6,465,994	-	1,249,158,843
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(941,172,336)		(73,006,037)	(17,754,464)	(1,031,932,837)
Totali	(941,172,336)	-	(73,006,037)	(17,754,464)	(1,031,932,837)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2021	301,520,513	-	(66,540,043)	(17,754,464)	217,226,006

27. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Përshkrimi	31 dhjetor 2020				
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	291,056,387		421,462,387		712,518,774
Mjete monetare në arkë dhe bankë	86,231,211				86,231,211
Totali	377,287,598	-	421,462,387	-	798,749,985
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(567,362,304)		(161,250,978)	(23,712,139)	(752,325,421)
Totali	(567,362,304)	-	(161,250,978)	(23,712,139)	(752,325,421)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2020	(190,074,706)	-	260,211,409	(23,712,139)	46,424,564

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Përshkrimi	31 dhjetor 2021			
	EUR	ALL	USD	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	1,026,156,235	111,599,986		1,137,756,221
Mjete monetare në arkë dhe bankë	96,767,296	7,569,194	7,066,132	111,402,622
Totali	1,122,923,531	119,169,180	7,066,132	1,249,158,843
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera Hua	(320,851,780)	(425,633,005)	(285,448,052)	(1,031,932,837)
Totali	(320,851,780)	(425,633,005)	(285,448,052)	(1,031,932,837)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2021	802,071,751	(306,463,825)	(278,381,920)	217,226,006

28. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Përshkrimi	31 dhjetor 2020			
	EUR	ALL	USD	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	610,952,561	101,566,213		712,518,774
Mjete monetare në arkë dhe bankë	28,864,459	56,852,165	514,587	86,231,211
Totali	639,817,020	158,418,378	514,587	798,749,985
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(263,495,548)	(407,791,407)	(81,038,466)	(752,325,421)
Hua				-
Totali	(263,495,548)	(407,791,407)	(81,038,466)	(752,325,421)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2020	376,321,472	(249,373,029)	(80,523,879)	46,424,564

29. ANGAZHIME DHE PASIGURI*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2021 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

30. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.